



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 7625/2026
Data: 12.08.2026

PROCESVERBALI I KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

Nga mbledhja e shtatë -VII- për vitin 2026 e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më datë 21.07.2026, me fillim pune në orën 11:00, në sallën e takimeve. Të pranishëm ishin: Sevdî Dernjani (Nënkryetar i Komunës), Abduraman Bushi (Drejtor për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural), Lindita Ballazhi (Drejtoreshë për Buxhet dhe Financa), Senad Kalisi (Drejtor për Shërbime Publike dhe Emergjencë), Arbenita Bajramaliu (Drejtoresh për Kulturë, Rini dhe Sport), Nexhmedin Daci (Drejtor për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), Bajrush Laçi (Udhëheqës i Zyrës Ligjore), Bashkim Sopa (Zyrtar për Transparencë).

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Raporti financiar për periudhën Janar – Qershor 2026.
3. Raporti i auditorit të përgjithshëm për Komunën e Hani të Elezit për vitin 2025.
4. Plani i veprimit të Komunës së Hani të Elezit për adresimin e rekomandimeve të raportit të auditimit 2025.
5. Propozim vendim për miratimin e ofertës së përzgjedhur për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të paluajtshmërisë komunale.
6. Informatë për aktivitetet e këshillit komunal për siguri në bashkësi për gjashtë mujorin e parë të vitit 2026.
7. Raportin financiar për periudhën Janar – Qershor 2026 i N.P.L “Pastrimi” sh.a.
8. Informatë për sektorin e emergjencave.
9. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson: Për pikat e rendit të punës hapi diskutimin. Nëse nuk ka, e hedh në votim rendin e punës. Rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar

Kryesuesi thekson: Për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin. Nëse nuk ka, e hedh në votim. Rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Raporti financiar për periudhën Janar – Qershor 2026.

Kryesuesi thekson: Për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Lindita Ballazhi thekson: Buxheti përfundimtar i komunës së Hanit të Elezit për vitin është në shumë prej 4,957,985.57 €, ku në këtë shumë përfshihen mjetet e ndara nga grantet qeveritare në shumë prej 3,877,962 €, projeksioni i të hyrave vetanake në shumë prej 356,720.00 €, donacion nga Unioni Evropian për projektin dyvjeçar “A Smart System for Early Floods Detection and Waste Monitoring in the Lepenc River Basin” në shumë prej 141,903.98 €, bartja e bilancit të pashpenzuar nga viti 2025 në vitin 2026 në shumë prej 580,184.23 €, donacioni nga Këshilli i Evropës në shumë prej 1,101.68 €, mjetet e mbetura nga grantet, të cilat janë bartur vit pas viti, në vlerë prej 113.68 €. Të hyrat vetanake deri me datën kur po raportoj janë në shumë prej 101,455.62 € dhe në raport e kam sqaruar se nga muaji prill deri tash nuk kemi regjistruar të hyra për shkak se jemi në mungesë të zyrtarit të të hyrave, mirëpo tash jemi pajisur me qasje në SIMFK për regjistrimin e të hyrave dhe do të regjistrohen këto të hyra në mënyrë manuale. Bazuar në krahasimet e vitit të kaluar, kemi një ndryshim të të hyrave me një diferencë prej 971,628.98 €. Kemi pranuar edhe të hyrat indirekte prej divizionit të të hyrave 57,072.48 €, pra kemi një inkasim më të lartë në krahasim me vitin e kaluar. Shpenzueshmëria totale e buxhetit për periudhën raportuese Janar – Qershor 2026, duke i përfshirë të gjitha kategoritë buxhetore, është në shumë prej 1,838,537.22 € apo 30.08%. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak 2025, shpenzimi total ka shënuar rritje prej 79,998.78 € apo 4.55% më shumë. Materialin e keni në mënyrë të detajuar dhe, nëse keni ndonjë pyetje apo sugjerim, mund të parashtroni.

Medina Imishti thekson: Në faqe dy e keni paraqitur totalin e buxhetit, ndërsa te tabelari, faqe gjashtë, te totali i përgjithshëm nuk është llogaritur donacioni i Evropës dhe mendoj që është gabim teknik dhe për mbledhje të kuvendit duhet të përmirësohet. Faqe katërmëdhjetë keni paraqitur kompensimin e përfaqësimit brenda vendit mbi shtatëmbëdhjetë mijë euro dhe, nëse ka mundësi, për mbledhje të kuvendit të komunës, për secilin aktivitet që e ke renditur të jetë edhe vlera se sa është shpenzuar. Te lista e investimeve kapitale, a janë vetëm këto projekte që janë realizuar dhe pse nuk janë realizuar edhe projektet e tjera.

Lindita Ballazhi thekson: Gabimet teknike do të përmirësohen për mbledhje të kuvendit të komunës. Te lista e projekteve kapitale, ata që janë sqaruar kanë pasur shpenzim. Përfaqësimet brenda vendit do të rregullohen dhe do të përcillen për mbledhje të kuvendit të komunës.

Kryesuesi thekson: A keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës? Nëse nuk ka, e hedh në votim. Rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTUA RAPORTI FINANCIAR PËR PERIUDHËN JANAR – QERSHOR 2026 QË T'I PËRCILLET KUVENDIT

3. Raporti i auditorit të përgjithshëm për Komunën e Hanit të Elezit për vitin 2025.

Kryesuesi thekson: Për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Lindita Ballazhi thekson: Nga ky raport kemi pranuar pesë rekomandime, e që prej tyre katër janë të përsëritura dhe një rekomandim i ri. Rekomandimi i parë ka të bëjë me dobësi në përgatitjen e raportit vjetor financiar për vitin 2025. Rekomandimi i dytë ka të bëjë me nënvlerësimin e regjistrit të pasurisë në PFV. Rekomandimi i tretë ka të bëjë me keqklasifikimin e shpenzimeve. Rekomandimi i katërt ka të bëjë me vonesa në pagesën e faturave dhe shpenzimeve të tjera shtesë për pagesat e ekzekutuara nga thesari. Rekomandimi i pestë ka të bëjë me mos themelimin e njësisë së auditimit. Të gjitha këto rekomandime janë shqyrtuar dhe është përgatitur edhe plani i veprimit për këto rekomandime.

Menduh Vlasi thekson: Së paku gjashtëmbëdhjetë vite jam marrë me raporte të auditimit dhe raport më i keq, ishalla, nuk na vjen ma, dhe të gjitha të gjeturat janë që janë gjetur edhe vitin e kaluar dhe nuk kanë marrë masa. Auditorët e përdorin njëfarë fjalie në tri-katër vende: “Rreziku i moszbulimit i një keqdeklarimi që rezulton nga mashtrimi është më i lartë me atë që rezulton nga gabimi.” Ato të gjetura ose janë bërë nga gabimet që nuk kanë ditur me punuar, ose që janë munduar me mashtruar dhe mu duk shumë e rëndë që auditori me përdorë kësi fjale, e që udhëheqësit e komunës ose nuk kanë ditur dhe i kanë bërë gabimet, ose kanë tentuar mashtrime. Për mu është shumë e rëndë dhe më herët nuk më kujtohet që është përdorur kjo fjali, ndërsa sa i përket të gjeturave do të diskutojmë në mbledhje të kuvendit të komunës.

Bajrush Laçi thekson: Sa i përket auditimit, është njëfarë standardi, është përdorur, nuk është se komuna ka udhëhequr keq, sepse kudo përdoret ky standard.

Kryesuesi thekson: A keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës? Nëse nuk ka, e hedh në votim. Rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTUA RAPORTI I AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM PËR KOMUNËN E HANIT TË ELEZIT PËR VITIN 2025 QË T'I PËRCILLET KUVENDIT.

4. Plan i veprimit të Komunës së Hanit të Elezit për adresimin e rekomandimeve të raportit të auditimit 2025.

Lindita Ballazhi thekson: Në bazë të këtyre të gjeturave nga raporti i auditimit është përgatitur edhe plani i veprimit, që mendohet që të zbatohen këto rekomandime. Sa i përket rekomandimit të parë, do të shtohet kontrolli gjatë hartimit të pasqyrave vjetore financiare. Gjithashtu, do të përmirësohen edhe databazat e të dhënave, të cilat janë pjesë e pasqyrave vjetore financiare. Sa i përket rekomandimit të dytë, ka pasur disa lëshime të regjistrimit të pasurisë. Për rekomandimin e tretë, disa shpenzime janë ekzekutuar drejtpërdrejt nga thesari për kontratën kolektive dhe ka rezultuar si keqklasifikim të shpenzimeve për këto lëndë, që ne nuk i kemi ekzekutuar drejtpërdrejt nga komuna, por nga thesari. Ne kemi dhënë komente në Zyrën Kombëtare të Auditimit që mos të kemi kësi të gjeture, sepse ne nuk i kemi ekzekutuar ato lëndë, por janë ekzekutuar drejtpërdrejt nga thesari dhe ne nuk duhet të jemi përgjegjës për këtë keqklasifikim, e Zyra Kombëtare e Auditimit ka vendosur që kjo të jetë si e gjetur jo vetëm për komunën tonë, por në çdo komunë tjetër. Sa i përket vonesave të obligimeve financiare, ka të bëjë me disa lëndë që shkojnë drejtpërdrejt në thesar nga kontrata kolektive, të cilat ekzekutohen drejtpërdrejt nga thesari dhe nuk ka të bëjë me komunën, por disa vijnë drejtpërdrejt tek ne me vendime gjyqësore e disa të tjera ekzekutohen nga thesari në mungesë të mjeteve për t'i ekzekutuar këto obligime. Çështja e mos themelimit të njësisë së auditimit të brendshëm, ne do të bëjmë përpjekje që të planifikojmë një auditor të brendshëm dhe, nëse kërkesa jonë miratohet në Ministri të Financave, duhet të bëjmë plotësim-ndryshimin e statutit të komunës për me shtuar një nënprogram buxhetor që ka të bëjë me njësinë e auditimit të brendshëm.

Menduh Vlasi thekson: Shumica e këtyre të gjeturave janë prej vitit të kaluar dhe kjo i bie që auditori ua ka tërhequr vërejtjen, por ju as që jeni mërzhitur. Nëse sot t'i ka shënuar këto të gjetura dhe në vitin e ardhshëm i ke përsëri të njëjtat, për mu është katastrofë, që do të thotë që as që interesohet dikush në këtë komunë për me punuar, për me përmirësuar gjendjen.

Medina Imishti thekson: Në dy rekomandimet e para përgjegjëse është Drejtoria për Buxhet e Financa dhe më intereson me ditë se si keni planifikuar për me i eliminuar këto tri rekomandime.

Lindita Ballazhi thekson: Te përpilimi i pasqyrave kryesore financiare është obligimi i zyrtarit kryesor financiar me i hartuar, normalisht me ndihmën e drejtorit. Me gjithë atë, në këtë raport të pasqyrave financiare ne i përmbledhim aktivitetet e të gjitha drejtorive të tjera, pra kemi të hyrat që përfshihen nga drejtoritë e tjera dhe këta zyrtarë të tjerë mbajnë një databazë për këto aktivitete, si të hyra, shpenzime, dhe ka pasur disa lëshime në mbajtjen e këtyre databazave. Gjatë muajit janar të vitit 2027, kur të hartohen pasqyrat vjetore financiare për vitin aktual, do të shtrojmë kontrollin që këto databaza të jenë sa më të sakta, në mënyrë që në vitin e ardhshëm mos ta kemi këtë rekomandim, pra do të mundohemi ta eliminojmë si gjetje.

Kryesuesi thekson: A keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës? Nëse nuk ka, e hedh në votim. Rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU PLANI I VEPRIMIT TË KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT PËR ADRESIMIN E REKOMANDIMEVE TË RAPORTIT TË AUDITIMIT 2025 QË T'I PËRCILLET KUVENDIT

5. Propozim vendim për miratimin e ofertës së përzgjedhur për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të paluajtshmërisë komunale.

Kryesuesi thekson: Për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Nexhmedin Daci thekson: Komisioni vlerësues ka përfunduar të gjitha procedurat ligjore për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të komunës, në pajtim me vendim paraprak të kuvendit të komunës. Bëhet fjalë për katër parcela, dy në Pusteni dhe dy në Rezhancë. Interesimi për marrjen me qira ka qenë i vogël dhe për një parcelë në fshatin Rezhancë është paraqitur vetëm një ofertë. Komisioni ka vlerësuar se oferta e pranuar nga z. Bedri Imishti për parcelën me numër 792 në Rezhancë i plotëson të gjitha kushtet e përgjithshme dhe kriteret e përgjithshme të përcaktuara me njoftimin publik, andaj edhe e ka miratuar këtë ofertë. Të bashkëngjitura i keni të gjitha materialet. Gjatë gjithë kësaj procedure nuk ka pasur asnjë ankesë dhe të gjitha procedurat kanë shkuar mirë.

Visar Hasllari thekson: Për pronat e tjera që nuk ka pasur aplikues, çka do të ndodhë me ta, çfarë procedura do të zhvillohen?

Nexhmedin Daci thekson: Për mendimin tim, është mirë me dalë përsëri, por procedurat janë të komplikuar dhe janë të njëjta sikur me dhënë një pronë në qendër të Ferizajt e sikur me dhënë në Gorancë dhe nuk ia vlen, dhe ju e dini se fshatrat tona gati se kanë mbetur të zbrazëta dhe pronat e tyre nuk janë duke i punuar dhe zgjidhja më e mirë do të ishte që vetëm me ia dhënë dikujt, a e punon, por ligji nuk i lejon dhe ne për herë të parë kemi arritur me zhvilluar një procedurë, të cilën e kemi zhvilluar në bazë të ligjit.

Kryesuesi thekson: Përfituesit a i kufizohet se çka do të punon?

Nexhmedin Daci thekson: Edhe me ligj, edhe me njoftim publik janë të paraqitura se për çka kanë me shfrytëzuar dhe qëllimi se për çfarë jepet, pra për aktivitete bujqësore, dhe nuk lejohet për aktivitete të tjera apo qëllime të tjera, pra ky është kufizimi i parë. Kufizimi i dytë është që fituesi nuk ka të drejtë që të drejtën e shfrytëzimit me bartur te personat e tjerë.

Menduh Vlasi thekson: I shikova komisionet dhe pashë që z. Endrit Ballazhi nuk ka nënshkruar, znj. Mevlane Kalisi në dy apo tri komisione nuk ka nënshkruar dhe nuk janë të lëvdueshme. Kur komisioni nuk nënshkruan, është dashur me pasur një arsyetim.

Nexhmedin Daci thekson: Për atë ligji e parasheh që me qenë pesë anëtarë edhe në komision vlerësues, edhe në komision të ankesave. Znj. Mevlane Kalisi është thirrur, por nuk ka marrë pjesë për shkak se ishte tu punuar në Kaçanik, por vazhdimisht ka qenë e njoftuar.

Menduh Vlasi thekson: Nënshkrimi duhet të jetë dhe pjesëmarrja në komision duhet të jetë. Nëse për arsye se është i sëmurë, por duhet të zëvendësohet e jo me mbetur raporti pa nënshkruar, për arsye se më vonë krijohet bindja se ky ka pasur probleme me komisionin.

Nexhmedin Daci thekson: Komisioni për atë përshihet që të jetë prej pesë anëtarëve, se nëse një mund të mungojë, se është si kuvendi, sepse nëse shumica nuk merrni pjesë në mbledhje, nuk mbahet kuvendi. Unë po flasë për komisionin për vlerësim, që të gjithë raportin përfundimtar e kanë nënshkruar, për shkak se e kanë pa dokumentacionin se i ka shkuar procedura dhe e ka nënshkruar.

Kryesuesi thekson: A keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës? Nëse nuk ka, e hedh në votim. Rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU PROPOZIM VENDIMI PËR MIRATIMIN E OFERTËS SË PËRZGJEDHUR PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PALUAJTSHMËRISË KOMUNALE QË T'I PËRCILLET KUVENDIT

6. Informatë për aktivitetet e këshillit komunal për siguri në bashkësi për gjashtëmujorin e parë të vitit 2026.

Kryesuesi thekson: Për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Sevdi Dernjani thekson: Në gjashtëmujorin e vitit 2026 janë mbajtur gjithsej tre mbledhje. Në këtë mbledhje marrin pjesë Kryetari i komunës si kryesues i këshillit, Komandanti i stacionit policor, Përfaqësuesi i Policisë kufitare, vija e gjelbër, Përfaqësuesi i këshillit të bashkësisë islame, Kryesuesi i komitetit për komunitete, Zyrtari për Komunitete dhe Kthim, Përfaqësuesi për barazi gjinore, Drejtori i drejtorisë për arsim, Përfaqësuesi i këshillit të prindërve, Përfaqësuesi i FSK-së, Drejtori i drejtorisë për shërbime publike dhe emergjencë, ndërsa Përfaqësuesit e KVRL-së në këto mbledhje nuk kanë marrë pjesë. Në këto mbledhje diskutohen çështje të cilat kanë të bëjnë me sigurinë dhe ju jepen rekomandime institucioneve përgjegjëse. Materialin e keni pranuar me kohë dhe, nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim, mund të parashtroni.

Menduh Vlasi thekson: Do të ishte mirë që me i shënuar emrat e përfaqësuesve.

Sevdi Dernjani thekson: Shënohet përfaqësuesi se komandanti dihet që është z. Nuhi Dema. Shënohet përfaqësuesi sepse mund të dërgojë përfaqësues në mbledhje dhe është procesverbali i mbledhjes, të cilët evidentohen se kush ka marrë pjesë në mbledhje dhe për atë shënohet si përfaqësues.

Menduh Vlasi thekson: KKSBB-në e përbën kryetari i komunës, por ti si nënkryetar mundesh me udhëhequr, komandanti i stacionit policor, z. Nuhi Dema, por ai mund ta dërgojë një përfaqësues, Drejtori i Shërbimeve Publike, por mund ta dërgojë një përfaqësues. Në KKSBB a vetëm e paraqitni shkatërrimin e parkut, çështjen e qenve endacakë, çështjen e dukurive negative? A ka ndonjë raport se cilat masa janë ndërmarre?

Kryesuesi thekson: Te kjo pikë, në këtë dy apo tre mujorë, ka punë sepse jemi në sezonën e verës për shkak të ardhjes së mërgimtarëve dhe punët duhet të bëhen më seriozisht, duke i përfshirë zjarrfikësit dhe në shëndetësi me pasur më shumë parasysh se ka shumë fluks të qytetarëve.

Sevdi Dernjani thekson: Në KKSBB i japim rekomandime komandantit të stacionit policor dhe të vijës së gjelbër, nuk është se ke kompetenca me bërë diçka tjetër, sepse ju e dini siç funksionon KKSBB-ja.

Visar Hasallari thekson: KVR-ja nuk merr pjesë në mbledhje të KKSBB-së për shkak se është një vendim prej Qeverisë dhe të gjitha KVRL-të në Republikën e Kosovës, me vendim të Kryeministrit, nuk i japin raport as drejtorive të arsimit, as drejtorisë së kulturës, por i japin nivelit qendror. Rruga jonë prej Lagjes së Re që shkon për Gorancë dhe për Maqedoninë Veriore, është mirë që drejtorja për shërbime publike me vendosur pengesa. Komandantin të policisë ju kam adresuar me kërkesë zyrtare, sepse natën, pas orës njëzet e katër, po ka lëvizje të skuterëve dhe motorëve dhe qytetarët nuk po munden me fjet për shkak të zhurmës.

Kryesuesi thekson: A keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës? Nëse nuk ka, e hedh në votim. Rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU INFORMATA PËR AKTIVITETE E KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI PËR GJASHTËMUJORIN E PARË TË VITIT 2026, QË T'I PËRCILLET KUVENDIT.

7. Raportin financiar për periudhën Janar–Qershor 2026 i N.P.L. “Pastrimi” sh.a.

Kryesuesi thekson: Për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Senad Kalisi thekson: Kryesuesja e komisionit të aksionarëve ma dha raportin dhe, nëse ka ndonjë pyetje apo sugjerim, ju përgjigjem edhe me shkrim.

Menduh Vlasi thekson: Edhe informatë, edhe raport nuk shkojnë bashkë, ose duhet të jetë informatë për periudhën, sepse, nëse është raport, duhet të miratohet, ndërsa informata nuk miratohet. Kërkoj informacion për punëtorët teknikë që janë shënuar pesë, kush i paguan.

Visar Hasallari thekson: Performanca e të hyrave nga shërbimet, të hyrat për periudhën janar–qershor janë në shumë prej 134 000 €, a janë këto të hyra edhe për vendimin e Kuvendit, të cilin e kemi marrë në shumë prej njëzet e pesë mijë euro?

Senad Kalisi thekson: Z. Sevime Luri është kryesuese e komisionit të aksionarëve dhe unë nuk kam shumë informacione për këtë raport, por ia përcjell dhe, nëse është e nevojshme, do t'i ftoj për në mbledhje të Kuvendit të Komunës me qenë prezentë.

Kryesuesi thekson: A keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës? Nëse nuk ka, e hedh në votim. Rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTU RAPORTI FINANCIOAR PËR PERIUDHËN JANAR–QERSHOR 2026 I NPL “PASTRIMI” SH.A, QË T'I PËRCILLET KUVENDIT

8. Informatë për sektorin e emergjencave.

Kryesuesi thekson: Për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Senad Kalisi thekson: Materialin e keni pranuar me kohë dhe, nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim, mund të parashtroni.

U VOTU INFORMATA PËR SEKTORIN E EMERGJENCAVE, QË T'I PËRCILLET KUVENDIT

9. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson: A keni ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës? Nëse nuk ka, e shpalli të mbyllur mbledhjen.

Mbledhja përfundoj në ora 12:37.

Procesmbajtësi

Ayni Bushi

